



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA MALIQ

KËSHILLI I BASHKISË

Datë 30.09.2022

Prot.63 (gjashtëdhjetëtre)

Protokoll nr. 63

I mbajtur sot më datë 30.09.2022, në mbledhjen e radhës së Këshillit të Bashkisë Maliq, në sallën e mbledhjeve të këshillit të bashkisë, ora 10:00.

Rend Dite:

- 1.Hapja e mbledhjes (korumi, miratimi i rendit të ditës, vendimet e mbledhjes së kaluar);
- 2.Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së datës 31.08.2022;
- 3.P-V “Për miratimin e Ndhmës Ekonomike deri në masën 6% të fondit për muajin gusht 2022”;
- 4.P-V “Për shpenzime varrimi subjektit “Nertila Hamataj”;
- 5.P-V “Për miratimin e listës së përfituesve nga programi “Banesë me kosto të ulët”, ndërtuar nga Enti Kombëtar i Banesave”;
- 6.P-V “Për detajimin e fondeve (transfera specifike) për ritjen e pagave për vitin 2022”;
- 7.P-V “Për miratimin e Raportit të II-të të Monitorimit të buxhetit për 8 mujorin e vitit 2022”;
- 8.P-V “Për disa shtesa dhe ndryshime në Vendimin nr.94, datë 24.12.2021 “Miratimin e numrit të punonjësve, nivelin e pagave të administratës së bashkisë dhe strukturave të saj, për vitin 2022”;
- 9.P-V “Për dhënien e miratimit të lidhjes së kontratës së huapërdorjes për pasurinë me nr.1/48-ND, zona kadastrale 2573, sipërfaqe 108 m², e llojit “ndërtesë”, midis Bashkisë Maliq dhe shoqatës “Klubi i Futbollit Maliq”;
- 10.P-V “Për dhënie ndihme financiare të menjëhershme për familjen e z.Robert Bicollit, banues në fshatin Tërovë, NJA Pojan, banesa e të cilit u dogj pjesërisht si shkak i rënies të zjarrit”;
- 11.Shqyrtimi i kërkesave drejtuar Këshillit të Bashkisë Maliq.
- 12.Diskutime të tjera.

Këshilltarë të pranishëm në sallë:

Ornildi Demollari; Valentina Pashollari; Rexhina Hëna; Floreta Zaçe; Aleksandër Petriti; Dritan Çami; Pranvera Begolli; File Qyrani; Jonilda Koçllari; Vasilika Trajko; Dorjan Zholanji; 11 (njëmbëdhjetë) këshilltarë.

Këshilltarë online në platformën ZOOM:

Esmeralda Spaho; Ildir Limellari; Fatjon Brahimllari; Kristina Malelli; Gentiana Drabo; Aldi Mullalli; Armando Dautllari; 7 (shtatë) këshilltarë.

Të pranishëm nga Administrata:

Zv/Kryetari i bashkisë znj.Jonila Xhihalli; Përgjegjëse e Sektorit të Shërbimit Social znj.Ermanda Petriti; Drejtore e Drejtorisë së Financës dhe Buxhetit znj.Almira Muka; Përgjegjës i Zyrës së Strehimit z.Ledion Mullalli; Jurist i Drejtorisë Juridike z.Nertil Çausi; Inxhinier i Drejtorisë së Urbanistikës z.Roneldi Spaho; Përgjegjës i Emergjencave Civile z.Stiljan Belishta.

Ornildi Demollari: Mirëdita të gjithëve!





Fillojmë mbledhjen e radhës së Këshillit të Bashkisë Maliq, me rendin e ditës jeni njohur dhe materialet e mbledhjes, verifikojmë korumin e mbledhjes, janë 11 këshilltarë në sallë dhe 7 të tjerë na ndjekin online, miratojmë rendin e ditës?

Kush është dakord ?

Kundra?

Abstenim?

Korumi realizohet, miratohet me 11 vota me karton nga këshilltarët në sallë dhe 7 vota nga këshilltarët online.

Miratohet me 18 vota pro! Faleminderit!

Dua t'i jap fajlën Kryetares së grupit të këshilltarëve socialist znj.Pranvera Begolli, për të lexuar material.

Pranvera Begolli: Përshëndetje!

Të nderuar këshilltarë,

Të nderuar qytetarë që na ndiqni,

Në emër të Aleances së Këshilltareve Bashkiakë Maliq, ju informojmë për punën e bërë nga aleanca, nismat e ndërmarra dhe arritjet.

Siç e dini, misioni i Aleancës së këshilltareve bashkiake është që të bashkojë gratë dhe burrat, anëtarë të këshillave bashkiake në Shqipëri, të punojë për të zhvilluar dhe advokuar për legjislacion, politika dhe nisma të tjera që i përgjigjen çështjeve që prekin nevojat e grave dhe komuniteteve, rritjen e barazisë gjinore dhe përfshirjes sociale. Gjej rastin të falenderoj projektin e Qeverisë Zviceriane “Bashki të Forta” për bashkëpunimin dhe mbështetjen e dhënë.

Aleanca e këshilltareve të bashkisë Maliq ka mbështetur dhe ka ndërmarrë nismat, si dhe shtron për zgjidhje çështjet si më poshtë:

1. Reduktim në masën 30% të tarifës për bizneset e reja që drejtohen nga gra kryefamiljare.
2. Përrjashtimi nga tarifat vendore i grave kryefamiljare që nuk janë në marrëdhënie pune.
3. Rehabilitimi i mjediseve të gjelbra dhe çlodhëse pranë banesave kolektive, me synim ofrimin e kushteve më të mira për nënat dhe fëmijët që i shfrytëzojnë ato, por dhe forcimin e komunitetit në bashkinë Maliq.
4. Përmirësimi i ndriçimit rrugor në qytetin Maliq dhe në fshatra, si dhe krijimi i një mjedisi të sigurt dhe miqësor për gratë dhe vajzat.

Gjithashtu, në muajin gusht 2022 Aleanca Kombëtare e Këshilltareve ka ndërmarrë fushatën ndërgjegjësuere “Përfshihu për qytetin tënd”. Ne synojmë që qytetarët të jenë aktivë e të përfshihen në çështjet e qeverisjes vendore. Në kuadër të kësaj fushate, ne hartuam një pyetësor për të marrë mendimin e qytetarëve në lidhje me profilin që duhet të ketë kandidati për këshilltar bashkiak. Deri më sot rreth 1000 qytetarë kanë përcjellë mendimin e tyre përmes përgjigjeve të administruara prej kryesisë së Aleancës Kombëtare të Këshilltareve.

Disa nga kriteret të cilat mund të ndihmojnë për krijimin e një profili për këshilltarët janë;

- 1- Cilësi menaxheriale të mira të imazhit publik në një garë elektorale. Një platformë e qartë elektorale nga një figurë e pastër e kandidatit potencial.
- 2- Aftësi shumë të mira komunikuese me zgjedhësit duke shërbyer si një urë komunikimi ndërmjet zgjedhësve dhe këshillit bashkiak për çështjet kombëtare e lokale me aftësi shumë të mira për të dëgjuar pikëpamje të ndryshme dhe njëkohësisht i qartë për dhe në vendimmarrje.





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

3- Aftësi shumë të mira të të kuptuarit të çështjeve politike, të të kuptuarit dhe identifikuarit të nevojave të komunitetit duke i artikuluar dhe mbrojtur interesat e komunitetit në komisionet e këshillit, mbledhjet dhe më gjerë.

4- Mbështetës i fortë i parimeve demokratike, me integritet dhe standarte të larta morale. Aftësi shumë të mira përshtatëse për punën në grup dhe njëkohësisht dhe me partitë e tjera. Prezantimi i këtyre kriterëve shpresojmë të sjellë edhe njëherë në vëmendje dhe sensibilizojë qytetarët dhe aktorët vendimmarrës, për një profil sa më të denjë të kandidatëve për anëtare të Këshillave bashkiakë.

Ju faleminderit! Sa për kujtesë në FB, është hapur një faqe (Aleanca e Këshilltareve Gra Maliq) ftojme qytetarët të na ndjekin.

Ornildi Demollari: Faleminderit Pranvera! Vazhdojmë me rendin e ditës, dua t'ju njoh me vendimet e mbledhjes së kaluar, duke marrë dhe dakortësinë e Prefektit. Janë 5 vendime, 2 me karakter normativ dhe 3 me karakter kolektiv.

Vendimi nr.78 datë 31.08.2022

“Për disa shtesa dhe ndryshime në Vendimin nr.94 datë 24.12.2021 “Miratimin e numurit të punonjësve, nivelin e pagave të Administratës të Bashkisë dhe strukturave të saj, për vitin 2022”;

Vendimi nr.79 datë 31.08.2022

“Për rishpërndarjen e buxhetit të bashkisë Maliq për vitin 2022”;

Vendimet me karakter Kolektiv:

Vendimi nr.75 datë 31.08.2022

“Për miratimin e Ndhmës Ekonomike deri në masën 6% të fondit për muajin korrik 2022”;

Vendimi nr.76 datë 31.08.2022

“Për dhënie ndihme financiare të për familje në nevojë”

Vendimi nr.77 datë 31.08.2022

“Për emërtimin “Rreze drite”, të kopshtit të ri në qytetin e Maliqit;

Ornildi Demollari: Këto ishin 5 vendimet, miratojmë protokollin e mbledhjes së kaluar?

Kush është dakord ?

Kundra?

Abstenim?

Korumi realizohet, miratohet me 11 vota me karton nga këshilltarët në sallë dhe 7 vota nga këshilltarët online.

Miratohet me 18 vota pro!

Faleminderit!

Kalojmë te pika e 3-të e rendit të ditës? P-V “Për miratimin e Ndhmës Ekonomike deri në masën 6% të fondit për muajin gusht 2022”; Ka ndonjë pyetje? E kalojmë në votim?

Kush është dakord ?

Kundra?

Abstenim?

Korumi realizohet, miratohet me 11 vota me karton nga këshilltarët në sallë dhe 7 vota nga këshilltarët online.

Miratohet me 18 vota pro!

Faleminderit! Kalojmë te pika e 4-t e rendit të ditës? P-V “Për shpenzime varrimi subjektit “Nertila Hamataj”;





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

Pranvera Begolli: Kam një pyetje, Alma këta janë njerëz që kanë kohë që kanë ndërruar jetë, po e miratojmë tani se nuk kishte fonde?

Drejtores e Drejtorisë së Financës dhe Buxhetit znj. Almira Muka: Po.

Ornildi Demollari: Dakord! E kalojmë në votim?

Kush është dakord ?

Kundra?

Abstenim?

Korumi realizohet, miratohet me 11 vota me karton nga këshilltarët në sallë dhe 7 vota nga këshilltarët online.

Miratohet me 18 vota pro!

Faleminderit!

Kalojmë te pika e 5 e rendit të ditës? “Për miratimin e listës së përfituesve nga programi banesë me kosto të ulët ndërtuar nga Enti Kombëtar i Banesave”;

Pranvera Begolli: Komisioni të na sqarojë si është ndjekur procedura. Kam vetëm një shqetësim, pjesa që ju takon mbi vlerën koston e ka sa trualli i Korçës 41 mijë lekë, Maliqi e ka 28 mijë lekë.

Përgjegjës i Zyrës së Strehimit z.Ledion Mullalli: Sot po miratojmë listën e fundit të familjeve të cilat do të përfitojnë banesa me kosto të ulët, ndërtuar nga EKB. Dua të falenderoj Entin Kombëtar të Banesave për mundësinë që na ka dhënë për të ndihmuar këto familje. Kjo është lista e fundit që ne miratojmë, pasi kemi miratar një listë në një mbledhje më parë.

Përzgjedhja e familjeve është bërë në bazë të 4 kushteve të cilat janë, kushtet e strehimit, kushtet sociale, familjare dhe kushtet ekonomike. Ne kemi përzgjedhur familje të cilat i kalojnë këto kushte dhe që plotësojnë të ardhurat për të paguar këstin e kredisë.

Kemi 3 familje që përfitojnë banesë 2+1 dhe 5 familje 3+1, familjet janë renditur sipas sistemit të pikëzimit dhe sipas kushteve familjare. Nëse ka diçka?

Pranvera Begolli:Do kërkoja të publikoheshe lista te faqja e Bashkisë.

Përgjegjës i Zyrës së Strehimit z.Ledion Mullalli: Vendimet janë publike te faqja e Bashkisë.

Valentina Pashollari: Ka familje që plotësojnë këto 4 kushte dhe sa janë?

Përgjegjës i Zyrës së Strehimit z.Ledion Mullalli: Ka mbetur dhe një familje që plotëson kushtet, nëse një familje nuk pranon të të lidhë kontratën me EKB, kjo familje shpallet fituese.

Ornildi Demollari:Faleminderit! Ja japim fjalën drejtorit të EKB Korçë.

Drejtori i EKB-së Korçë: Përshëndetje! Ju falenderoj për bashkëpunimin që kemi patur deri tani, për miratimin në kohë të listave. Lidhur me shqetësimin e këshilltarëve, çminin e pjesës shtesë është e përcaktuar me ligj, shtesa mbi normativat do paguhet me çmimin e tregut. Në kontratat që u lidhën qyetarët kishin nga 10m²- 20m², që është 6 mijë lekë për m², e cila i shtohet koston të banesës dhe do shlyhet bashkë me vlerën e banesës për një afat 15 vjeçar.





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

Kjo vlerë u vendos nga Këshilli drejtes i EKB-së sipas të gjitha rregullave, duke marrë çmimin nga agjencitë imobilare dhe kontratë me noterët.

Lidhur me çmimin 28 mijë lekë që tha këshilltarja është çmimi tatimor, ky çmim është i vjetër. Ju faleminderit!

Ornildi Demollari: Faleminderit! Ilir! Ka ndonjë pyetje tjetër? E kalojmë në votim?

Kush është dakord ?

Kundra?

Abstenim?

Korumi realizohet, miratohet me 11 vota me karton nga këshilltarët në sallë dhe 7 vota nga këshilltarët online.

Miratohet me 18 vota pro!

Faleminderit! Kalojmë te pika e 6 e rendit të ditës? P-V “Për detajimin e fondeve(transferta specifike)për ritjen e pagave për vitin 2022”; Kush e do fjalën?

Pranvera Begolli:Drejtoresha të japë shpjegim?

Drejtoresha e Drejtorisë së Financës dhe Buxhetit znj.Almira Muka: Në muajin korrik u bë shtesa e pagës për Edukatorët e kopshtit, nga qeveria erdhi një fond për ritjen e pagave dhe kjo transfertë specifike kërkon vendim Këshilli të ndahet paga dhe sigurime.

Ornildi Demollari:Faleminderit! Ka ndonjë pyetje tjetër? E kalojmë në votim?

Kush është dakord ?

Kundra?

Abstenim?

Korumi realizohet, miratohet me 11 vota me karton nga këshilltarët në sallë dhe 7 vota nga këshilltarët online.

Miratohet me 18 vota pro

Faleminderit!

Kalojmë te pika e 7 e rendit të ditës? P-V “Për miratimin e Raportit të II-të Monitorimit të buxhetit për 8 mujorin e vitit 2022”;

Zv/Kryetari i Bashkisë znj.Jonila Xhiahalli: Përshëndetje! Raportit i Monitorimit tregon zbatimin e buxhetit për 8-mujorin, na tregon qartë 8-mujorin, na tregon qartë sa janë realizuar të ardhurat dhe shpenzimet për 8-mujorin. Është bërë një analizë specifike për 13 programet buxhetore të cilat kemi dhe është bërë një analizë e detajuar të treguesve të performancës. Për më tepër mund të na sqarojë dhe Drejtoresha e Financës.

Pranvera Begolli: Ky Raport është një tregues me ato çka kemi bërë nga ato që kemi miratuar ne.

Ornildi Demollari: Faleminderit! Ka ndonjë pyetje tjetër? E kalojmë në votim Raportin e Monitorimit?

Kush është dakord ?

Kundra?

Abstenim?

Korumi realizohet, miratohet me 11 vota me karton nga këshilltarët në sallë dhe 7 vota nga këshilltarët online.

Miratohet me 18 vota pro!

Faleminderit!





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

Kalojmë te pika e 8 e rendit të ditës? P-V “Për disa shtesa dhe ndryshime në Vendimin nr.94 datë 24.12.2021 “Miratimin e numurit të punonjësve, nivelin e pagave të Administratës të Bashkisë dhe strukturave të saj, për vitin 2022”;

Pranvera Begolli: P-V ta miartojmë se ka ardhur me VKM rritja e pagës minimale, por unë do doja që mos kemi punonjës me 6-7 orë në Bashki.

Valentina Pashollari: Nuk mund ti bëjmë me 8 orë të gjithë nuk kanë shumë ngarkesë.

Ornildi Demollari: Ka ndonjë pyetje tjetër? E kalojmë në votim?

Kush është dakord ?

Kundra?

Abstenim?

Korumi realizohet, miratohet me 11 vota me karton nga këshilltarët në sallë dhe 7 vota nga këshilltarët online.

Miratohet me 18 vota pro

Faleminderit!

Kalojmë te pika e 9 e rendit të ditës? P-V “Për dhënien e miratimit të lidhjes së kontratës së huapërdorjes për pasurinë me nr.1/48-ND, zona kadastrale 2573, sipërfaqe 108 m², e llojit “ndërtesë”, midis Bashkisë Maliq dhe Shoqatës “Klubi i Futbollit Maliq”;

Pranvera Begolli: Mund të na shpjegoni pak më qartë, cila ndërtesë do jepet? Arseyea?

Zv/Kryetari i Bashkisë znj.Jonila Xhihalli: Ndërtesa ekezisuese te Stadiumi, sepse duhet të fillojë procesi i rregjisitrimit duhet të ketë një dokument që ka akt pronësie.

Pranvera Begolli:Nuk është pronë Bashkie ndërtesa?

Zv/Kryetari i Bashkisë znj.Jonila Xhihalli:Po është pronë bashkie dhe bashkia ja jep me qira Klubit të Futbollit.

Pranvera Begolli: U miratua sisShoqatë?

Zv/Kryetari i Bashkisë znj.Jonila Xhihalli:Po u miratua.

Pranvera Begolli:Ta kishit informuar Këshillin, që Klubi i Futbollit ka kaluar si Shoqatë.

Ornildi Demollari: Është miratuar dhe me vendim gjykate është rregjistruar dhe në tatimet, ka nxjerë dhe nipt dhe vazhdon aktivitetin dhe kështu bashkia duhet të lidhë kontratë për ndërtesën dhe fushën.

Ka ndonjë pyetje tjetër? E kalojmë në votim?

Kush është dakord ?

Kundra?

Abstenim?

Korumi realizohet, miratohet me 11 vota me karton nga këshilltarët në sallë dhe 7 vota nga këshilltarët online.

Miratohet me 18 vota pro!

Faleminderit!





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

Kalojmë te pika e 10 e rendit të ditës? P-V “Për dhënie ndihme financiare të menjëhershme për familjen e z.Robert Bicolli, banues në fshatin Tërovë NJ.A Pojan, banesa e të cilit u dogj pjesërisht si shkak i rënies të zjarrit”; Ka nevojë për shpjegim?

Përgjegjës i Emergjencave Civile z.Stiljan Belishta: Është e njëjta procedurë që është ndjekur si për rastet e tjera, të cilat janë miratuar me VKB dhe më pas marrin konfirmimin e Prefektit. Bëhet fjalë për një banesë e cila është djegur si pasojë e rënies së zjarrit në rruajin korrik në orën 12.30 min, procedura është standarde që i referohet VKM-së i referohet VKM-së nr. 329, për vlerësimin e dëmeve. Ku është bërë një përlllogartije e grupit të punës të ngritur me urdhër të Kryetarit të Bashkisë, ku vlera e dëmit është 323 mijë lekë. Kjo është një ndihmë e menjëhershme që i vjen në ndihmë familjes.

Ornildi Demollari: Ka ndonjë pyetje tjetër?

Valentina Pashollari: Pse ka ardhur me vonesë P-V në Këshill?

Përgjegjës i Emergjencave Civile z.Stiljan Belishta: P-V është bërë gati në kohë 15 ditë pasi në banesë ra zjarri, por nuk e kemi futur në mbledhjen e parë, për shkak të mungesës së disa punonjësve për të firmosur.

Valentina Pashollari: Punonjësit të jenë më të përgjegjshëm në këto raste. Të ketë zëvendësues në këto raste.

Përgjegjës i Emergjencave Civile z.Stiljan Belishta: Grupi i punës ngrihet me Urdhër të Kryetarit të bashkisë, ku ka pjestarë nga disa zyra.

Ornildi Demollari: Ka ndonjë pyetje tjetër? E kalojmë në votim?

Kush është dakord ?

Kundra?

Abstenim?

Korumi realizohet, miratohet me 11 vota me karton nga këshilltarët në sallë dhe 7 vota nga këshilltarët online.

Miratohet me 18 vota pro

Faleminderit!

Kalojmë te pika e tjetër e rendit të ditës? Janë 3 P-V që kanë ardhur 1 ditë me vonesë, P-V “Për rishpërndarjen e buxhetit të bashkisë Maliq për vitin 2022”;

Drejtores e Drejtorisë së Financës dhe Buxhetit znj. Almira Muka: Për shkak të rritjes së çmimit të materialve ngrohese në buxhetin e vitit 2022 është llogaritur fondi me çmimet atë momentin, tani çmimi për pellet dhe gaz u rrit, nuk merrnim dot atë sasi që duheshe në 7 shkolla vendosëm të bënim këtë levizje, nga shpenzime operative të kalojnë për pellet dhe gaz.

Pranvera Begolli: Cilat janë shpenzimet operative që do preken?

Drejtores e Drejtorisë së Financës dhe Buxhetit znj. Almira Muka: Nga aparati për zbulime i keni dhe të shpjeguar në relacion dhe nga MKSZH për pajise dhe uniforma. Ky është një vit i vështirë si për karburant dhe kancelari që ndikon në punën tonë.

Ornildi Demollari: Faleminderit! Ka ndonjë pyetje tjetër? E kalojmë në votim?

Kush është dakord ?

Kundra?





Abstenim?

Korumi realizohet, miratohet me 11 vota me karton nga këshilltarët në sallë dhe 7 vota nga këshilltarët online.

Miratohet me 18 vota pro

Faleminderit!

Kalojmë te pika e tjetër e rendit të ditës? Për detajimin dhe përdorimin e fondit “Për Mbrojtjen Civile” për një ndryshim në vendimin 66 datë 01.07.2022, Alma një shpjegim dhe këtu?

Drejtores e Drejtorisë së Financës dhe Buxhetit znj. Almira Muka: Në muajin korrik ka ardhur një fond i pakushtëzuar nga Emergjencat Civile, rreth 10 milion lekë, ne kemi marrë vendim ku do të përdoshin, por doli më emergjente rehabilitimi i urave dhe kjo është levizja në buxhet, është e njëjta si te P-V i parë.

Ne do bëjmë bazamentin e urave në zonën e Gorës, urat do i ndërtojë Ministria e Mbrojtjes, fonde do pakësohen nga rastet e rënies së zjarrit dhe pajise kundra zjarrit në njësitë administrative.

Ornildi Demollari: Dakort! E qartë, E kalojmë në votim?

Kush është dakord ?

Kundra?

Abstenim?

Korumi realizohet, miratohet me 11 vota me karton nga këshilltarët në sallë dhe 7 vota nga këshilltarët online.

Miratohet me 18 vota pro

Faleminderit!

Kalojmë te pika e tjetër e rendit të ditës? P-V “Për rishpërndarjen e buxhetit të bashkisë Maliq për vitin 2022”;

Drejtores e Drejtorisë së Financës dhe Buxhetit znj. Almira Muka: Me buxhetin shtesë që miratua në shkurt, kishim parashikuar blerjen e një autoboti për thitjen e ujërave të zeza. Ujësjellësi do bëhet rajonal dhe këtë shërbim do e mbulojnë vetë ata, këtë fond do e kalojmë për blerje fadrome, fondet i kishim dhe në buxhetin e vitit 2022, fondet i pakësuam nga buxheti dhe i shtuam te Mbrojtja Civile.

Ornildi Demollari: Dakord! E qartë, e kalojmë në votim?

Kush është dakord ?

Kundra?

Abstenim?

Korumi realizohet, miratohet me 11 vota me karton nga këshilltarët në sallë dhe 7 vota nga këshilltarët online.

Miratohet me 18 vota pro

Faleminderit!

Sot na erdhi dhe një P-V tjetër, do kërkoja mirëkuptimin ta miratonim, P-V “Për miratimin e dhënies në përdorim pa kundërshpërblim, të pasurive nr.1/185, sipërfaqe 68 m² dhe nr.1/115, sipërfaqe 26 m², të llojit “truall” zona kadasrale 2573, Maliq, në favor të Drejtorisë Vendore të Policisë Korçë”; bëhet fjalë për Komisariatin e Policisë, bashkia jonë e ka të nevojshme këtë godinë.

Pranvera Begolli: Atje thuhet që janë dy godina, pjesa që u ndërtua dhe pjesa aktuale?





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

Ornildi Demollari: Janë 2 pasuri, sipërfaqe 68 m² dhe nr.1/115, sipërfaqe 26 m², të llojit “truall”.

Pranvera Begolli: Godina e parë ka qenë pronë bashkie? Të vijë juristi ta sqarojë.

Nertil Çausi Jurist: Unë kam hartuar vetëm bazën ligjore të P-V, dikush nga urbanistika mund ta dijë.

Ornildi Demollari: Sa të vijë specialisti, lexojmë kërkesat drejtuar Këshillit të Bashkisë Maliq, po ja u lexoj kërkesat;

Jonel Dinoshi banor i fshatit Desimrë NJA Gorë, kërkon ndihmë fiancaire pasi i është djegur banesa dhe nuk kam mundësi financiare ta riparoj.

Pranvera Begolli: Kërkesat që kanë të bëjnë me fonde të paraqiten me P-V nga sektori përkatës.

Zv/Kryetari i Bashkisë znj.Jonila Xhihalli: Kërkesa t’i drejtohet sektorit përkatës të ndiqen të gjitha procedurat dhe të paraqitet P-V.

Valentina Pashollari: Me sa kuptoj ai nuk e ka pasur shtëpinë e tij, dhe nqs do ti ndjekë procedurat i ndjek ai që ka patur shtëpinë në pronësi, ky kërkon ndihmë financiare.

File Qyrani: Personi në fjalë është vërtet në vështirësi financiare dhe e ka të pamundur të ndjekë këto procedura, ai thjesht ka bërë një kërkesë për ndihmë financiare, ne jemi të detyruar t’i kthejmë përgjigje, t’i hapet drita jeshile për ndihmë.

Ornildi Demollari: Ne jemi të detyruar ta shqyrtojmë dhe ta drejtojmë te sektori përkatës. Ecim me 2 kërkesat e tjera dhe kalojmë te P-V, kërkesa dërgohet nga NJA Gorë dhe ka të bëjë me 5 nxënës nga fshati Mesmal dhe 8 nxënës nga fshati Strelcë që nuk vijnë në mesimin në shkollën e Lozhanit për shkak të kostos të rrugës, nuk e përballojnë dot nga Mesamli kushton 400 lekë nga Strelca 200 lekë, mungesa e nxënësve krijon problem për hapjen e vitit të parë, kërkojmë nga Këshilli një financim në masën 50%.

Gentiana Drabo: Duke qenë se kjo ka të bëjë me arsimin, po ndërhyj pak për të sqaruar këshilltarët dhe qyetarët se çfarë mbulon zyra arsimore për transportin e nxënësve që lëvizin jashtë vendbanimit, ZVAR mbulon vetëm nxënësit e arsimit të detyruar nga klasa 1-9. Për arsimin VKM-ja nuk siguron financim se nuk është arsim i detyruar, nqs se ka mundësi nga Këshilli dhe bashkia për t’i ndihmuar kjo është çështje tjetër, ndërkohë nxënësit vazhdojnë mesimin pavarshisht vështirësisë.

Ornildi Demollari: Faleminderti Genta!

Valentina Pashollari: T’i ndihmojmë me bursa këta nxënës kur të vijë koha e bursave.

Zv/Kryetari i Bashkisë znj.Jonila Xhihalli: Këta nxënës do shikohen me prioritet në hartimin e e buxhetit të vitit 2023.

Pranvera Begolli: Jam dakord të ndihmohen fëmijët me buxhetin e vitit 2023, por ata duhet të shikohen që tani se po vjen periudha e dimrit, të shikojmë fond rezervë për këtë periudhë.

Zv/Kryetari i Bashkisë znj.Jonila Xhihalli: Do shikohet me prioritet.

Ornildi Demollari: Kemi dhe një kërkesë tjetër po nga NJA Gorë, për zgjedhjen e Kryetarit të fshatit Selcë, Kryetari i fshatit Selcë është larguar jashtë vendit dhe ka bërë kërkesë për





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

dorëheqje. Këshilli të marrë vendim për zgjedhjen e Kryetarit të ri Velçan-Selcë. Kjo është për njohje.

Valentina Pashollari: Nuk bëhen më zgjedhje 6 muaj para procesit të votimit.

Ornildi Demollari: Kthehemi te P-V që lamë pa shqyrtuar, -V“Për miratimin e dhënies në përdorim pa kundërshtpërblim, të pasurive nr.1/185, sipërfaqe 68 m² dhe nr.1/115, sipërfaqe 26 m², të llojit “truall” zona kadasdrale 2573, Maliq, në favor të Drejtorisë Vendore të Policisë Korçë”;Roneld na jep një shpjegim këto prona janë pronë e bashkisë?

Inxhinier i Drejtorisë së Urbanistikës z.Roneldi Spaho: Po këto janë pronë e bashkisë, janë në inventarin e bashkisë, njëra rrugë, tjetra shesh.

Ornildi Demollari: Pasuritë nr.1/185, sipërfaqe 68 m² dhe nr.1/115, sipërfaqe 26 m², të llojit “truall” zona kadasdrale 2573.

Inxhinier i Drejtorisë së Urbanistikës z.Roneldi Spaho: Godina ekzistuese ka certifikatë pasurie, bëhet fjalë për shtesën.

Pranvera Begolli: Flasim për truall jo për ndërtesat, ndërtesat kush i ka në pronësi?

Inxhinier i Drejtorisë së Urbanistikës z.Roneldi Spaho: I ka ministria.

Ornildi Demollari:Ju ftoj ta kalojmë, më vonë me gentplan sqarojmë këshillin. E kalojmë në votim?

Kush është dakord ?

Kundra?

Abstenim?

Korumi realizohet, miratohet me 11 vota me karton nga këshilltarët në sallë dhe 7 vota nga këshilltarët online.

Miratohet me 18 vota pro

Faleminderit!

Kjo ishte mbledhja për sot, ju uroj ditë të mbarë në vazhdim!

KRYETARI I KËSHILLIT

Ornildi DEMOLLARI

